

**RAPORTI
PËRFUNDIMTAR
I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT:**

Master Profesional:
në
“SHKENCA POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE”,
drejtimi **“Politika Sociale”**

SHKOLLA E LARTË PRIVATE
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË

Tiranë, maj 2012

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm

1. Prof. Dr. Edmond DRAGOTI
2. Prof.Assoc. Dr. Merita XHUMARI

Hyrje

Përbërja e GVJ

3. Prof. Dr. Edmond DRAGOTI
4. Prof.Assoc. Dr. Merita XHUMARI

Parimet e Punës së GVJ

- Besimi
- Vlerësimi i mbështetur në dokumenta të paraqitura nga GVB, Institucioni etj.
-

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional ne Shkenca Politike dhe Administrative me drejtime: Politika Sociale dhe Administrate Publike dhe qeverisje vendore

- Të dhëna për hapjen e programit të studimit

Tabela format për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Master Profesional ne Shkenca Politike dhe Administrative , mbështetur në Standardet shtetërorë për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Po, sasia e krediteve është sipas kriterit. Sasia e krediteve për një student është 60 ECTS kredite sipas Udhëzimit përkatës, Nr.18, datë, 04.04.2008.
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin për të përgatitur specialistë të aftë në fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, shkencave politike dhe administratës publike.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programi është hartuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet nevojave që paraqet tregu i punës me njohuri në fushat e shkencave ekonomike, marrëdhënieve ndërkombëtare, shkencave politike dhe administratës publike, duke i përgatitur ata që të orientohen në mënyrë të saktë në tregun e punës.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh zhvillimet në aspektin ekonomik, politik dhe social, si pasojë e ndryshimeve që ndodhën në vendin tone pas viteve 1990.

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programi pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit tonë referuar literaturave të studjuesve shqiptarë.
Konkluzione: Programet e studimeve që ofron institucioni janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij duke përmbushur në këtë mënyrë kriteret e standardit I.1.	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Po, është hartuar në përputhje me strategjitë afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të institucionit me të cilën u konsultuam gjatë vizitës në UMSH.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Po, nga hartimi i programit gjykohet se i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike përmes moduleve bazë të cilat japi n njohuri teorike mbi konceptet dhe metodat shkencore bashkëkohore si dhe parashikimit të praktikave në institucionet publike qendrore në vend për trajnim shkencor e profesional.
Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Kriteri përmbushet, pasi programi Master është konceptuar dhe ndërtuar mbi bazën e zhvillimit logjik të formimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve në shkenca politike.
Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	—
Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;	Po, kriteri gjen zbatimin e tij referuar formatit të programit i cili parashikon semestrin e parë njohuri bazë teorike e mbi metodat e kërkimit shkencor dhe në semestrat e tjerë njohuritë thellohen me zhvillimin e njohurive në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale në fushën e administrates publike e marrëdhënieve ndërkombëtare. Studentët gjatë intervistës u shprehën se ata për këtë qëllim kanë zgjedhur të vazhdojnë studimet në këtë nivel.
Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;	Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative
Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	Programi ka objektiva të qartë profesionale për formimin e ekspertëve të administratës publike në nivel qendror e lokal, si dhe në arritjen e përshtatjes së tyre në institucionet e politikës sociale me synime të justifikueshme për kualifikimin në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ende nuk është diplomuar

	brezi i parë i studentëve që të verifikohen këto objektiva të përcaktuara në program.
Konkluzione: Programi i studimeve “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative” është në përputhje me kriteret e standardit I.2. mbi strategjinë e zhvillimit të institucionit.	
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Po, në hartimin e programit të studimit janë plotësuar të gjitha parakushtet dhe kushtet sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307 datë 22.07.2010 dhe Udhëzimet përkatëse të MASH.
Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Po, emërtimet e programit të studimit respektojnë emërtimet në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.
Konkluzione: Standardi I.3 me kriteret e tij gjejnë zbatim në përputhjen e Programit të studimeve “Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative” me aktet ligjore e nënligjore në fuqi sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307 datë 22.07.2010 dhe Udhëzimet përkatëse të MASH.	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;	Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit është që të diplomuarit të pajisen me njohuritë e thelluara dhe aftësi të nevojshme për tregun e punës.
Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve dhe aftësive arësytuese, argumetuese dhe kritike të studentëve të UMSH bëhet nëpërmjet provimeve me shkrim e gojë dhe formave të ndryshme të testeve - sipas përcaktimit në program dhe testeve me përgjigje alternative të depozituara në sekretarinë e UMSH.
Konkluzione: Standardi gjen zbatim të plotë lidhur me përshtatjen e programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative dhe nivelin e studimeve.	
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane	Po, verifikua se programi i studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në Shkenca Politike mbështetet në përvojën dhe praktikën e shquar të universiteteve të vendeve evropiane, si Francë, Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar, Itali dhe Greqi.
Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në metodatat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;	Programi i studimit është ndërkombëtarisht konkurrues përderisa bazohet në programe të shteteve anëtare të BE ku Shqipëria synon të bashkohet, e veçanërisht të vendeve fqinje si Itali e Greqi ku shqiptarët lëvizin për punësim. Kështu programi afirmon e forcon traditën më të mirë të arsimit universitar shqiptar për të përballuar sfidat e kohës.

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Po, është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. (f8-9)
Konkluzione: Standardi 1.5 me kriteret e tij gjen plotësisht zbatim në programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative i cili është ndërkombëtarisht konkurrues, veçanërisht në vendet e Ballkanit.	
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Programi pajis studentët me baza të qëndrueshme njohurish dhe me aparatën teorik e konceptual për të zhvilluar kërkimin shkencor përmes njohurive mbi metodat e avancuara të kërkimit shkencor.
Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Po, programi i studimeve ka për qëllim e mision përgatitjen e specialistëve të aftë në fushat e shkencave ekonomike, marrëdhënieve ndërkombëtare, shkencave politike dhe administratës publike, duke i përgatitur ata që të orientohen në mënyrë të saktë në tregun e punës.
Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	Personeli akademik i UMSH zhvillon punë shkencore duke i prezantuar ato në konferenca të organizuara nga vetë UMSH dhe institucione të tjera kërkimore shkencore brënda dhe jashtë vendit dhe publikuar në revistën shkencore të UMSH-së, Euromediterranean apo revista të tjera prestigjioze shkencore në Shqipëri dhe jashtë.
Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Po, puna kërkimore shkencore e personelit akademik të UMSH nëpërmjet punimeve të ndryshme prezantohet në konferenca të vetë UMSH-së dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me synimet për arritjen e qëllimeve të programeve të studimit.
Konkluzione: Ka përmbushje të plotë të këtij standardi nga programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative.	
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programi synon t’u përgjigjet dhe paraprijë nevojave të tregut të punës për njohuri në fushat e shkencave ekonomike, marrëdhënieve ndërkombëtare, shkencave politike dhe administratës publike.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Programi synon të plotësojë nevojat në fushën e administratës publike, ekonomisë së tregut, marrëdhënieve ndërkombëtare në Shqipëri e në rajon.
Konkluzione: Masteri Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative ofrohet sipas kërkesave të tregut vendas dhe rajonal.	
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	

Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Po, programi i përgjigjet modernizimit të administratës publike dhe përputhet me synimet strategjike të zhvillimit të vendit drejt një ekonomie tregu konkurruese në Ballkan.
Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	UMSH ka planifikuar kryerjen e dy studimeve vlerësuese dhe pikërisht në tremujorin e parë të vitit 2012 për studimin e mundësive të punësimit të të diplomuarve të rinj dhe në tremujorin e fundit të vitit 2012 për verifikimin e nivelit të të diplomuarve të UMSH-së, por ende të përealizuara.
Konkluzione: Ky standard plotësohet nga programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative por që realisht nuk ka të realizuar vlerësimin e nevojave të tregut të punës.	
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;	Institucioni i përmbahet këtij kriteri i specifikuar në faqen 12 të tij dhe i zbatuar në praktikë.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Programet përmbushin plotësisht këtë kriter në konceptimin bashkëkohor dhe në njohjen e realiteteve shqiptare përmes një literature të studjuesve vendas dhe praktikave profesionale në institucionet prestigjioze në vend.
Konkluzione: Standardi plotësohet sipas kriterëve që përmban nga programi Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative konceptimi bashkëkohor dhe njohja e realiteteve shqiptare përmes një literature të studjuesve vendas dhe praktikave profesionale në institucionet prestigjioze në vend.	
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Po, vërehet zbatimi i kriterit nga institucioni, parashikohen metoda vlerësimi me konsulta akademike, me konsulentë të brendshëm e të huaj, ndonëse ende nuk janë zbatuar sepse programi sapo ka filluar.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	Po, kriteri gjen përcaktim në faqen 13 të programit, ndonëse ende nuk ka gjetur zbatim në terren.
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Po, plotësohet kriteri përkatës në websitin e UMSH I cili është lehtësisht i aksesueshëm www.umsh.edu.al
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të	Po, kërkesat e kriterit përmbushen plotësisht. Në faqen 13 pershkruhen të gjitha këto metoda vlerësimi të tërthorta dhe të drejtpërdrejta.

<p>studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Konkluzione: Standardi gjen zbatim në të gjitha kërkesat e kriterëve të tij në konceptim, ndonëse në praktikë nuk ka ende vlerësime të programit të sapo nisur.</p>	
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni me anë të planit strategjik të tij I cili u konstatua gjatë vizitës në UMSH, realizon zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve. Se si këto do realizohen në praktikë, kjo do te verifikohet ne vijimësi, pasi ky është viti I pare I zbatimit të këtij programi.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Po, me përfundimin e vitit dhe nxjerrjen e rezultateve parashikohet të hartohet një plan për vlerësimin e tyre. f.14</p>
<p>Konkluzione: Standardi përmbushet nga institucioni I cili u konstatua gjatë vizitës në UMSH, I cili realizon zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve. Se si këto do realizohen në praktikë, kjo do të verifikohet në vijimësi, pasi ky është viti i parë i zbatimit të këtij programi.</p>	
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të</p>	<p>Master Profesional</p>

studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Ky kriter gjen zbatim lidhur me kreditet që kërkohen për programet e studimeve “Master Profesional”, përmban 60 ETC. Kohëzgjatja 1 vit.
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Master Profesional
Konkluzione: Vërehet përmbushje në disa drejtime të standardit.	
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;	UMSH ka programuar publikime të tilla, f.15 e programit, por që deri tani nuk ka publikime të tilla.
Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	Institucioni ka parashikuar publikime në website: www.umsh.edu.al , por që deri tani nuk ka publikime të tilla.
Konkluzione: Institucioni synon ta plotësojë standardin I.13, që deri tani nuk ka publikime të tilla.	
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.	
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Konstatohet zbatimi i kriterit pasi gjatë vizitës në UMSH, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ institucionit ishte mëse i familjarizuar me objektivat e programit dhe i gatshëm për zbatimin e tyre.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Vërehet angazhimi i personelit të institucionit për zbatimin e strategjisë për zhvillimin e institucionit.
Konkluzione: Ka angazhim të institucionit për standardin. F.16	
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Ka zbatim si institucion për këtë kriter i konstatuar në takimin me të gjithë drejtuesit e institucionit si dhe stafin e tyre mbështetës.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	Kriteri gjen zbatim me tre Fakultete: Fakulteti I Shkencave Ekonomike, I Shkencave Politike dhe

	Administratës Publike dhe në Fakultetin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Organizimi i fakultetit bëhet në përputhje me kriterin, ku Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administratës Publike ka dy departamente: Shkenca Politike dhe Administratë Publike.
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar; Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.	Vërehet zbatim i kriterit lidhur me përbërjen e institucionit me tre Fakultete: Fakulteti I Shkencave Ekonomike, I Shkencave Politike dhe Administratës Publike dhe në Fakultetin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Departamenti ka vetëm dy staff efektivë si personel akademik, nga të cilët vetëm 1 ka gradën shkencore “Doktor”, shefi i departamentit, sipas verifikimit në terren, sepse në program nuk paraqitet ky kriter.f.16
Konkluzione: Standardi nuk plotësohet në tërësi, pasi kërkohet plotësim i tij për kriterin 5 ku stafi akademik është I pamjaftueshëm në numër dhe në nivelin shkencor të kërkuar.	
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejtë dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Vërehet plotësim i këtij kriteri sipas vizitës në UMB dhe intervistave me stafin akademik dhe administrativ të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike.
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Vërehet plotësim i këtij kriteri sipas vizitës në UMB dhe intervistave me stafin akademik dhe administrative, në mbështetje të nenit 36, 37 të Statusit dhe Rregullores së UMSH.
Konkluzione: Standardi gjen zbatim në njësitë e institucionit.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Vërehet plotësim i këtij kriteri sipas vizitës në UMB dhe intervistave me stafin akademik, në mbështetje të Statusit dhe Rregullores së UMSH.
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Vërehet plotësim i këtij kriteri sipas vizitës në UMB dhe intervistave me stafin akademik, në mbështetje të Ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 i ndryshuar dhe me Udhëzimet e MASH, si dhe Statusit dhe Rregullores së UMSH, neni 27.
Konkluzione: Standardi përmbushet në drejtim të angazhimit të personelit akademik për zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Kriteri plotësuar, ndërtese 4 katëshe me mjedisë të bollshme dhe të pajisura mire për qëllimin e institucionit.

Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Kriter i plotësuar, kontratë qeraje 10vjeçare.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Programi ofrohet në një godinë që menazhohet mire për të realizuar qëllimin e institucionit.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Kriter i plotësuar, këto programe specifike nuk ofrohen.
Konkluzione: Kriteret e mësipërme të Standardit II.5 janë të plotësuara.	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve .	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Kriter i plotësuar I diskutuar edhe me studentët e intervistuar në UMSH
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Kriter i plotësuar, http://www.umsh.edu.al
Konkluzione: Kriteret e mësipërme të Standardit II.6 janë të plotësuara.	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Kriter që ende nuk është plotësuar pasi ende nuk ka përfunduar viti i parë i studimeve që të kryhet vlerësimi i tij, por që parashikohet në program.
Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Programet sapo kanë filluar.
Konkluzione: Kriter që ende nuk është plotësuar pasi ende nuk ka përfunduar viti i parë i studimeve që të kryhet vlerësimi i tij, por që parashikohet në program analiza vjetore e tij.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Është hartuar plani i diplomimit për ciklin e dytë të studimeve.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Master Profesional
Konkluzione: Planet e diplomimit në ciklin e dytë të studimeve janë hartuar, por ende nuk janë zbatuar sepse programi ka nisur këtë vit akademik.	
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në	UMSH parashikon auditimit nga AIEI Auditors. Programi sapo ka nisur dhe me përfundimin e tij do të

dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	bëhet edhe auditimi.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	UMSH parashikon auditimit nga AIEI Auditors. Programi sapo ka nisur dhe me përfundimin e tij do të bëhet edhe auditimi.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	UMSH parashikon auditimit nga AIEI Auditors. Programi sapo ka nisur dhe me përfundimin e tij do të bëhet edhe auditimi.
Konkluzione: Standardi për auditim të përvitshëm të situatës financiare është parashikuar, por ende nuk ka gjetur zbatim.	
III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.	
Standardi III.1	
- Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Procedurat janë të përcaktuara po stafi është ende i paplotësuar sipas standardeve të kërkuara.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë mbetet për tu plotësuar me rritjen e numrit të studentëve.
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Procedurat janë të përcaktuara po stafi është ende i pavlerësuar pasi programi sapo ka filluar.
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Po, sekretaria kishte gjithë dokumentacionin e organizuar me dosje të veçanta për stafin e brendshëm dhe stafin e angazhuar me orë si i jashtëm.
Konkluzione: Standardi nuk është përmbushur plotësisht në lidhje me plotësimin e stafit sipas kriterëve dhe vlerësimin e tij në këto fillime të programit gjatë këtij viti akademik.	
Standardi III.2	
- Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Po, kriteri i plotësuar nga Prof. Dr. Kosta Bjaraba në kohën e vlerësimit, i cili e ka fituar titullin shkencor PhD nga Universiteti i Tiranës dhe Professor nga Universiteti i Shkodrës.
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në	Kriteri i plotësuar

profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Po, kriter i plotësuar nga Prof.Dr. Kosta Bjaraba në kohën e vlerësimit, i cili e ka fituar titullin shkencor PhD nga Universiteti i Tiranës dhe Professor nga Universiteti i Shkodrës.
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Po, kriter që është në diskutim, përderisa mund të plotësohet nga stafi akademik i jashtëm që ka gradën shkencore PhD.
Konkluzione: Standardi lidhur me personelin akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulimin prej tyre te nevojave te institucionit gjen zbatim ne disa kriteret e tij. Konkretisht kriteri 3 mbetet i paplotësuar.	
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Ka parashikuar zbatimin e kriterit i cili zbatohet nga Titullari i Fakultetit dhe Departamentit.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Ka parashikuar zbatimin e kriterit i cili zbatohet nga Titullari i Fakultetit dhe Departamentit.
Konkluzione: Parashikohet të përmbushet ky standard sipas planifikimit të hartuar për këtë qëllim, pasi stafi akademik aktual me kohe të plotë nuk përmbush kriteret.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Ka të parashikuar mësimdhënie në gjuhë të huaj vetëm duke ftuar profesorë të huaj (Faqe 34), por jo nga stafi I brendshëm.
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Ka të parashikuar mësimdhënie në gjuhë të huaj vetëm duke ftuar profesorë të huaj (Faqe 34), por jo nga stafi I brendshëm.
Konkluzione: Ka të parashikuar mësimdhënie në gjuhë të huaj vetëm duke ftuar profesorë të huaj (Faqe 34), por jo nga stafi I brendshëm.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Master Profesional
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Master Profesional
Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës,	Master Profesional

shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	
Konkluzione: Master Profesional	
Standardi III.6	
- Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Kriteri është planifikuar për zbatim, por ende nuk ka gjetur zbatim sepse studimet sapo kanë filluar.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Programi e parashikon këtë kriter, por në praktikë ende nuk ka gjetur zbatim sepse studimet sapo kanë filluar.
Konkluzione: Ka parashikim por jo përmbushje të standardit në fillimet e këtij programi studimi.	
Standardi III.7	
- Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Kriteri i plotësuar me përkushtimin e stafit në ditët që UMSH u vizitua për vlerësimin e tij.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Kriteri i plotësuar me përkushtimin e stafit në ditët që UMSH u vizitua për vlerësimin e tij, një staf i pakët por eficient.
Konkluzione: Standardi ka gjetur zbatim.	
Standardi III.8	
- Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Kriteri i zbatuar, personeli indonese i pakët parashikohet në program të mbulojë disa module që të plotësojë ngarkesën mësimore me atë numër të kufizuar studentësh.
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi i drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Kriteri i zbatuar për 1 staf akademik, sepse stafi tjetër mbante edhe pozicione drejtuese si Dekan dhe Përgjegjës Departamenti.
Konkluzione: Standardi i plotësuar.	
Standardi III.9	
- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Po, kriteri i përmbushur, i verifikuar me dosjet e personelit gjatë vizitës në UMSH.
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	Kriteri i zbatuar i verifikuar me dosjet e personelit gjatë vizitës në UMSH.

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Kriter i zbatuar I verifikuar me dosjet e personelit gjatë vizitës në UMSH.
Konkluzione: Standard i përmbushur.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Po, i përmbushur. Pjesëmarrja në projekte të organizuara nga UMSH e stafit akademik dhe e personelit mesimor shkencor të pakët në numër, vetëm 1 staf akademik i cili vazhdon PhD në Greqi.
Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Po, kriter i zbatuar, personelit mesimor shkencor të pakët në numër, vetëm 1 staf akademik i cili vazhdon PhD në Greqi.
Konkluzione: Standard i përmbushur.	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore -shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Përmbushur, sipas CV së personelit akademik.
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Përmbushur, sipas CV së personelit akademik.
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Përmbushur, sipas CV së personelit akademik.
Konkluzione: Përmbushur.	
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Po, kriter i zbatuar, studentët kanë diploma Bachelor nga UT, apo universitete të tjera të akredituara në vend, të verifikuar gjatë vizitës në UMSH.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	—
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Po, kriter i zbatuar.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa	Nuk e ka të përcaktuar.

<p>për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve; Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	
<p>Konkluzione: Standard për t’u plotësuar.</p>	
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>Parashihet në program por nuk verifikohet në këto fillime të programit.</p>
<p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>	<p>Parashihet në program por nuk verifikohet në këto fillime të programit.</p>
<p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Kriteri parashihet në program por nuk verifikohet në këto fillime të programit, ndonëse ka një zyrë të Keshillimit të karrierës.</p>
<p>Konkluzione: Standard i parashikuar, por që mund të përmbushet në të ardhmen.</p>	
<p>Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	
<p>Konkluzione: Aplikon për herë të parë.</p>	
<p>Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>Kriter për t’u përmbushur pasi të diplomohet brezi i parë i studentëve.</p>

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Kriter për t'u përmbushur pasi të diplomohet brezi i parë i studentëve.
Konkluzione: Standard për t'u përmbushur pasi të diplomohet brezi i parë i studentëve.	
Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Kriter i zbatuar www.umsh.edu.al f.42.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Po, kriter për t'u plotësuar gjatë këtij viti të parë akademik të zbatimit të këtij programi.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Ende nuk janë përfunduar modulet.
Konkluzione: Standard për t'u përmbushur	
Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Kriter i zbatuar, sekretaria disponibël, studentët të kënaqur.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Kriter që parashikohet të zbatohet me dhomën e biznesit të Tiranës, shoqatën e bankave të Shqipërisë, etj.
Konkluzione: Standardi është në proces përmbushje.	
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Kriter i zbatuar I verifikuar gjatë vizites ne biblioteken e UMSH, si dhe shërbim interneti për studentët.f.42.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Po, kriter i venë në zbatim, përkthime të teksteve të autoreve klasike dhe botime të autoreve me të njohur Shqiptarë.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Kriter i zbatuar në lidhje me botimet periodike, por jo librari elektronike.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	Kriter që parashikohet të zbatohet në vazhdimësi.
Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Kriter i venë në zbatim, oraret shpallen në hollin e katit të parë dhe në hyrje të Bibliotekës.

Konkluzione: Standard i plotësuar, ka një administratë që administron fondin e bibliotekës, ndonëse ka nevojë të plotësohet për të përmbushur plotësisht kriterin 3.	
Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Kriter i plotësuar, I verifikuar gjatë vizitës në UMSH.
Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Po, kriteri vë në zbatim, pasi mjediset përdoren për seminare edhe nga jashtë institucionit.
Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	Shkencat politike nuk kanë ndonjë laborator të veçantë.
Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Shkencat politike nuk kanë ndonjë laborator të veçantë.
Konkluzione: Standardi është i përmbushur në nivele të kënaqshme.	
Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Kriter që do të zbatohet me dhomën e biznesit të Tiranës, shoqatën e bankave të Shqipërisë, sipas parashikimit në faqen 45 të programit.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	-----
Konkluzione: Standard që do të zbatohet me dhomën e biznesit të Tiranës, shoqatën e bankave të Shqipërisë, sipas parashikimit në faqen 45 të programit.	
VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;	Kriteri vë në zbatim ka dokumentuar raportet financiare të audituara nga AIEI për 2009-2010, dhe 2010-2011.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një	Po, kriteri zbatuar, ka dokumentuar raportet

qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	financiare të audituara nga AIEI për 2009-2010, dhe 2010-2011.
Konkluzione: Standard i përmbushur ka dokumentuar raportet financiare të audituara nga AIEI për 2009-2010, dhe 2010-2011.	
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1	
- Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Po, kriteri i zbatuar në kushtet që personeli i brendshëm përbëhet nga dy pedagogë.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Po, kriteri i zbatuar në kushtet që personeli i brendshëm përbëhet nga dy pedagogë.
Konkluzione: Standard i përmbushur.	
Standardi VII.2	
- Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	Kriteri që do të zbatohet me dhomën e biznesit të Tiranës, shoqatën e bankave të Shqipërisë, sipas parashikimit në faqen 45 të programit.
Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	Kriteri i zbatuar.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Kriteri për tu zbatuar pas punësimit të brezit të parë të studentëve
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Kriteri për tu zbatuar pas punësimit të brezit të parë të studentëve
Konkluzione: Standard për t'u përmbushur pas punësimit të brezit të parë të studentëve.	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1	
- Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	Kriteri i zbatuar.
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	Programet janë bashkëkohore dhe metodat e mësimdhënies janë shkencore. Stafin ndonëse i kufizuar i ka cilësitë për të qenë konkurrenës dhe mjediset edukojnë dhe nxisin sigurimin e cilësisë.

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	Kriteri është realizuar në programin e detajuar të paraqitur dhe procedurat për fillimin e tij.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Kriteri do të verifikohet në zbatim e sipër të programit që sapo ka nisur.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	Kriter që do të arrihet me rritjen e stafit akademik dhe numrit të studentëve.
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar në www.umsh.edu.al
Konkluzione:Standard i përmbushur.	

Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit

Pikat e forta

1. Programet e studimeve janë në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë e zhvillimit të tij.
2. Programet e studimeve janë në përshtatje me nivelin e studimeve, duke synuar arritjen e dimensioneve ndërkombëtare dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Pikat e dobëta

1. **Struktura zbatuese si Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”, ndërkohë që departamenti ka vetëm 2 anëtarë efektivë, nga të cilët vetëm 1 me gradën Doktor.**
2. **Institucioni duhet të stimulojë regjistrimin e studentëve për përmbushjen e misionit të tij.**

Kërcënimet

- 1 Institucioni nuk ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj dhe nuk kërkohet dhënia e provimit të gjuhës së huaj në përfundim të studimeve Master.
- 2 Personeli **akademik duhet të angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.**

Oportunitetet

1. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.
2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të tij bibliotekë dhe laboratorë të mjaftueshëm e mjedise të përshtatshme mësimore.

Rekomandimet

1. Institucioni duhet të forcojë programet studimore në përputhje me kërkesat e tregut.
2. Institucioni duhet të angazhojë personel akademik të mjaftueshëm për përmbushjen e misionit të tij.
3. Të parashikojë mbrojtjen e gjuhës angleze në përfundim të studimeve Master

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm

1. Prof. Dr. Edmond DRAGOTI
2. Prof. Assoc. Dr. Merita XHUMARI